



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 408/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër shpërndarjes së ulëseve në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Hudhet poshtë** si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 27.06.2014 në ora 12:05, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDAK, në të cilën ankesë pretendohet se me rastin e shpërndarjeve të ulëseve pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, ju ka bërë e padrejtë duke ia marr një ulëse subjektit politik PDAK të cilën ulëse sipas parashtruesit të ankesës KQZ-ja, ia ka dhen subjektit politik PAI. Më këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon së është bërë shkelje e nenit 64.2 të Kushtetutës së Kosovës në të cilën dispozitë sipas parashtruesit të ankesës specifiket se: vendi i katër i takon komunitetit e cila ka vota më shumë, me vet faktin formula e ndarjes së ulëseve nuk duhet të përdoret te komuniteti Rom, Ashkanli dhe Egjiptas (RAE), për arsye se Kushtetuta e definon ulësen e katërt ashtu është shkëlur ligji për zgjedhjet përgjithshme dhe pjesëmarrja e kuotës gjinore nga radhët e komuniteteve të lartpërmendura.

Më tutje parashtruesi i ankesës ka shtuar se subjekti politik PDAK për dallim prej subjekteve tjera politike e ka numërin më të madhë të votave të përgjithshme, pasi që subjekti politik PDAK në nga radhët e subjekteve të komunitetit RAE ka më se shumti vota. Kjo dëshmohet edhe nga raporti i QNR-së në të cilën shihet se:

- PDAK i posedon 3335 vota (QNR-ja një ulëse ju ka caktuar),
- PLE i posedon 1960 vota (QNR-ja një ulëse ju ka caktuar),
- PAI i posedon 1583 vota (QNR-ja një ulëse ju ka caktuar),
- IRDK i posedon 1456 vota (QNR-ja zero ulëse ju ka caktuar),
- KNRP i posedon 645 vota (QNR-ja një ulëse ju ka caktuar) dhe
- PRBK i posedon 642 vota (QNR-ja zero ulëse ju ka caktuar).

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur raportin e QNR-së lidhur me rezultatet përfundimtare.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

### **ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore të subjektit politik PDAK të parashtruara ndaj vendimit të KQZ-së lidhur me shpërndarjen e vendeve në parlament të Kosovës, janë të palejuar që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f.

Për më tepër në nenin 63.6 të LZP-së, është paraparë që vendimi i KQZ-së nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qarte me këtë ligj. Nga kjo rezulton se, si përjashtim nga ajo çka parashihet në këtë dispozitë juridike është neni 122 par. 1 i LZP-së, ku taksativisht janë paraparë çështjet për të cilat vendimi i KQZ-së mund të ankimohet, në mesin e të cilave nuk qëndron edhe çështja e caktimit nga ana e KQZ-së për shpërndarjen e ulëseve të subjekteve politike në Kuvend. Meqenëse në asnjërën nga pikat e lartpërmendura të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në ankesë, PZAP-i vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 408/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*